

STATUT I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Confutura Adria” SHPK

Kreu I

Themeli, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Në Tiranë, sot më date 23 Janar 2023 (dymijë e njezet e dy), nëmbështetje të ligjit dhe nëbazë të dispozitave ligjore të Ligjit Nr 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe Ligjit Nr 9723 datë 3.5.2007, ndryshuar me Ligjin nr. 9916, datë 12.05.2008, Ligjin Nr.92/2012 dhe Ligjin Nr.8/2015 “Për Qëndrën Kombëtare të regjistrimit” që rregullojnë marrëdhëniet tregtare dhe funksionimin e shoqërive, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin: **“Confutura Adria” SHPK.**

Themeluesit e shoqërisë është:

Z. Kujtim Memeti, lindur më 02/10/1988 ne Split, Kroaci, banues ne Bogovine, Rr. 101 Nr. BB, Maqedonia e Veriut, mbajtës i pasaportes nr. K0140808 me nr. personal 0210988380061 me aftësi të plotë juridike për të vepruar.

Shoqëria **“Confutura Adria” SHPK** e zhvillon veprimatarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dispozitat e parashikuara në dokumentat e krijuar të saj.

Shoqëria **“Confutura Adria” SHPK** është person juridik. Ajo e fiton këtë të drejtë si person juridik nga data e regjistrimit të kësaj shoqërie në QKB sipas Ligjit.

Neni 2:

Objekti

Shoqëria **“Confutura Adria” SHPK**, do të ushtrojë aktivitetin e saj në fushën e:

Telemarketing – Call Center, outbound, telefonata nderkombetare. Sherbime marketingu online apo jo, te cdo forme dhe tipi, direkt apo indirekt.

Neni 3:

Kohëzgjatja

Shoqëria **“Confutura Adria” SHPK** krijohet për të ushtruar aktivitetin e saj me një afat të pacaktuar. Kjo shoqëri ta mbyllë aktivitetin e saj edhe para mbarimit të këtij afati, e realizuar kjo sipas dispozitave që përcaktohen në këtë statut, me vendim të asamblesë së ortakëve dhe sipas kritereve që përcaktohen në legjislacionin në fuqi.

Neni 4:

Selia

Kjo shoqëri do ta ketë selinë e saj në adresën: Rruga “Hoxha Tahsim”, Hyrja 1, pasuria nr. 3/474-N5, Zona kadastrale 8150, Vol.56, Fq.55, Tirane.

Kreu II Kapitali

Neni 5 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i kësaj shoqërie përbhet në para (Lekë) në shumën prej 100 (njeqind) Lekë me 1 (nje) pjesë.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1.Ortaku themelues Kujtim Memeti – zoterues i 1 (një) kuote, në vlerë 100 (njeqind) lek që përbën 100% të kapitalit.

Kapitali themeltar ose pjesë të caktuara të tij janë të transferueshme nga Ortakët e kësaj shoqërie tek të tretët.

Të gjitha veprimataritë e shoqërisë mbi kapitalin themeltar në natyrë bëhen vetëm me miratimin e Asamblesë së Ortakëve. Vlerësimi i këtij kapitali bëhet nga ortaket e shoqërisë dhe me vendim të Asamblese se Ortakeve dhe nga një ekspert i autorizuar i caktuar nga vetë Asambleja e Ortakeve. Shoqëria **“Confutura Adria” SHPK**, për detyrimet që do të lindin gjatë aktivitetit të saj me të tretët përgjigjet vetëm me pasuritë e saj. Ortakëtë kësaj shoqërie nuk përgjigjen për detyrimet e kësaj shoqërie me pasuritë e tyre që nuk janë futur në kapitalin e kësaj shoqërie. Pjesëmarrja në këtë shoqëri nuk i pengon ortaket të kenë pavarësi ligjore, organizative dhe të drejta pronësie jashtë kësaj shoqërie.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.


Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në bazë të një pavarësie të plotë ekonomike. Ajo nuk pranon asnjë ndërhyrje nga organet shtetërore apo publike të cfarëdo lloji, përjashtuar kontrollit që ka të drejtë të bëjnë organet shtetërore kompetente në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund



të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- c) dhurimit;

d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çeshtjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çeshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.


Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë



vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë pér çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet pér shkak të mungesës së kuorimit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, pér ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, pér çështje te tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.


Neni 12

Përjashtimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim pér:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.



Neni 13

Administrimi

1. Kompania administrohet, ne menyre te alternuar, sipas vendimit te aksionarëve:

- a) nga një administrator i vetëm;
- b) nga dy ose më shumë administratore me kompetenca të përbashkëta, të ndara ose të ushtruara bashkarisht.

Me organ administrimi nenkuptohet administratori i vetëm ose grup i administratorëve që i është ngarkuar administrimi sebashku ose veç e veç.

Administratorët mundet qe te mos jene ortake te shoqerise.

Administratoret qëndrojë në detyrë deri në revokimin ose dorëheqje ose për periudhën e përcaktuar nga aksionarët në afatin e emërimit por jo me shume se 5 vjet dhe mund të riemërohen.

Nëse administratorët jane emëruar për një kohë të caktuar, shkarkimi para afatit detyron kompaninë për kompensim te çdo dëmi, përveç se kur ekziston një kauzë e drejtë.

Me "kauze të drejtë" nenkuptohet ndodhja e rrëthanave ose fakteve, edhe totalisht te panjohura nga administratori ose jashte vullnetit të tij, te tillë qe të minojne vazhdimin e marrëdhënieve së besimit që duhet të ekzistojë midis aksionarëve dhe administratoreve. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

2. Pushimi i administratoreve pershkak te perfundimit te afatit ka afekt nga momenti kur organi i ri i administrimit eshte emeruar.

Në rastet e parashikuara ne dy paragrafët e mësipërm, administratoret ende në detyrë, në rast të pamundësisë apo të inaktivitetit të tyre, organi mbikëqyrës, nëse është emëruar, duhet, brenda shtatë ditëve, ti paraqesi per vendimmarrje asamblese të aksionarëve emërimin e organit te ri te administrimit; ndërkohë që ata mund të kryejnë vetëm administrimin e zakonshem.

3. Organi i administrimit ka kompetenca të plota për menaxhimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë, pa përjashtim, dhe ka fuqinë për të ndërmarrë ndonjë veprim që e konsideron të përshtatshme për zbatimin dhe arritjen e qëllimit të kompanisë, përveç ato të cilat ligji apo statuti ja rezervon ne menyre ekskluzive asamblese se ortakeve.


4. Në rastin e emërimit të më shumë se një administratori të cilet nuk përbëjnë një keshill administrimi, kompetencat e zakonshme dhe të jashtëzakonshme administrative mund t'i atribuohet atyre bashkërisht, individualisht ose me shumice, pra kompetenca të caktuara mund t'i atribuohet të ndara dhe të tjera së bashku. Në mungesë të ndonjë percaktimi në aktin e emërimit në lidhje me format e ushtrimit të kompetencave, ato kompetenca nenkuptohet qe i jane dhene administratoreve bashkarisht.

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;



- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënrat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret Jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Administrator i per gjithshem i shoqerise do te jete:

Z. Kujtim Memeti, lindur më 02/10/1988 ne Maqedonine e Veriut, banues ne Bogovine, Rr. 101 Nr. BB, Maqedonia e Veriut, mbajtës i pasaportes nr. K0140808 me nr. personal 0210988380061 me aftësi të plotë juridike për të vepruar.

Emri, Mbiemri,	Specimen i firmës
Z. Kujtim Memeti	

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15 Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojet e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen

administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesht;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

c) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpérndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financier, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkuesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV

Viti financiar-ekspertet

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtmisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe

mbyllt me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

Eksperi ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithevjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperi kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

Kreu V

Prishja – riorganizimi i shoqërisë

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të Ligjit Nr 9723 datë 3.5.2007, ndryshuar me Ligjin nr. 9916, datë 12.05.2008, Ligjin Nr.92/2012 dhe Ligjin Nr.8/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “Shoperi ne likuidim e siper”.

Prishja e shoqërite tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19


Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.” i ndryshuar.

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e



legislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 21

Mosmarrëveshjet


Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"Confutura Adria" SHPK

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

Z. KUJTIM MEMETI



A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Kujtum Memeti' above 'Z. Memeti'. The signature is fluid and cursive.